

10-faktet për sigurinë rrugore në botë

Raportet për gjendjen globale për sigurinë rrugore 2013, të publikuar nga organizata Botërore e shëndetësisë (OBSH) është vlerësim i dytë i madh i gjendjes rrugore e cila i siguron mbështetje për Dekada të veprimit për sigurim të rrugëve 2011-2020 e publikuar nga Kuvendi i përgjithshëm të kombeve të Bashkuara.

Reparti paraqet informacion për sigurinë e rrugëve prej 182 vende, raportim për gati 99% e popullatës në botë.

Këto janë gjithsej 10 faktet për sigurinë e rrugëve:

1. Çdo vit në rrugët nëpër botë vdesin rreth 1.24 milion njerëz.

59% të viktimave janë të rinj dhe të rritur ndërmjet 15 dhe 44 vjet.

2. 92% e vdekjeve kanë ndodhur në vendet me të ardhura të ulët dhe të mesëm.

Këto vende kanë vetëm 53% nga të gjitha automjetet e regjistruara në botë.

3. Gjysma e të gjithë të vdekurve në aksidente trafiku janë të pambrojtur.

Këmbësorët,çiklistët,motoçiklistët dhe pasagjerët e tyre janë të njohur së bashku si përdorues të rrugëve të pambrojtura. Pjesëmarrja e tyre në aksidentet e trafikut është më e madhe në vendet me të ardhura të mesme se sa te vendet me të ardhura të larta.

4. Kontrollimi i shpejtësisë së veturave i redukton viktimat e trafikut.

Vetëm në 59 vende të cilat i mbulojnë 39% apo 2.67 miliard njerëz në botë,kufizojnë shpejtësinë e zbatuar në qytet 50km/h ose më pak i lejojnë qeveritë lokale për të zvogëluar kufizimet. Zvogëlimin e shpejtësisë mesatare për 5% mund ta zvogëlojë numrin e përplasjeve fatale deri në 30%.

5. Konsumimi i alkoolit dhe vozitja gjatë ndikimit të alkoolit e rit rrezikun për përplasje.

89-vende të cilat mbulojnë 66% nga popullata në botë, ose 4.55 miliard njerëz, kanë një ligj për vozitje gjatë drejtimit të mjetit nën ndikimin e alkoolit e cila e imponon rekomandimin nga OBSH për të kufizuar përqendrimin e alkoolit në gjak në 0.05 g/dl ose më pak. Mbi këtë rrezik përqendrimet e përplasjeve në trafik rritja është dinamike.

6. Mbajtja e helmetave kualitative mund të pakësoj rrezikun nga vdekjet deri në 40% me përplasjet në trafik.

Mbajtja e helmetave kualitative mundet gjithashtu ta pakësoj dhe rizikun nga lëndimet të rënda përmbi 70% të rasteve. 90vende të cilat kushtojnë 77% nga vendbanimet në botë, kanë ligje të detajuara për helmete e cila vlen për të gjithë çiklistët dhe motoçiklistët në të gjitha rrugët dhe në të gjitha llojet e makinave e cila përdoret për helmeta standarde.

7. Përdorimi i rripave të sigurimit e zvogëlon rizikun nga vdekjet te pasagjerët në ulësen e përparme për 40-65%.

Përdorimi i rripave të sigurimit gjithashtu zvogëlon vdekjet te pasagjerët në ulësen e pasme për 25 deri 70%. 111 vende me 69% e popullatës në botë kanë ligje të detajuara për rripat e sigurimit të cilat vlejné për të gjithë pasagjerët në makinë.

8. Ulëset për fëmijë, ulëset për fëmijët e vegjël dhe ulëset shtesë mundë ta zvogëlojnë vdekjen te fëmijët për 54% deri 80% gjatë aksidenteve rrugore.

Më shumë se gjysma e të gjitha vendeve kanë zbatuar ligj gjatë përdorimit të makinave me fëmijë.

9. Të shpejtë dhe me cilësi të parë-spitalore të kujdesit mund të shpëtojnë jetën e shumë njerëzve të lënduar në aksidentet rrugore.

111 vende kanë numër universal kombëtar për të hyrë në shërbimet e urgjencës në dispozicion për të transmetuar më shumë se 75% e pacienteve të plagosur në spital.

10. Prej vitit 2007, 88-vende në botë e kanë zvogëluar numrin e vdekjeve në aksidentet rrugore.

Kjo sugjeron se përparimi është i mundur nëse ka angazhim të mjaftueshëm politik. Megjithatë në 87 vende numri i vdekjeve në aksidentet rrugore është rritur, ndërsa në nivelin global numri i vdekjeve ka mbetur i qëndrueshëm.